



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1452/24 Datë: 23.07.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 125-të, mbajtur me datë 03.07.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Arkitekturë MSc 120 ECTS (me 5 specializime) 1.Arkitektura e Qëndrueshme; 2. Projektimi Arkitektonik; 3. Urbanizëm dhe Planifikimi Hapësinor; 4. Trashëgimia Arkitekturale; 5. Arkitektura dhe Teknologjia, me kuotën maksimumi 75 studentë për vit akademik,*
 - *Arkitekturë, BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<p><i>Arkitekturë MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 75 studentë për vit akademik, (me 5 specializime)</i></p> <p>1. <i>Arkitektura e Qëndrueshme;</i> 2. <i>Projektimi Arkitektonik;</i> 3. <i>Urbanizëm dhe Planifikimi Hapësinor;</i> 4. <i>Trashëgimia Arkitekturale;</i> 5. <i>Arkitektura dhe Teknologjia,</i></p>	<p>Teuta Jashari Kajtazi Violeta Nushi Vlora Navakazi Dukagjin Hasimja Florina Jerliu Arta Jakupi</p>
2.	<p><i>Arkitekturë, BSc 180 ECTS,</i></p>	<p>Rozafa Basha Ardita Byci Jakupi Flaka Xërxa Beqiri</p>

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Arkitektura MSc 120 ECTS (me 5 specializime)***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Philippe Bouillard, Ivana Milicevic dhe Nadia Manzoni është organizuar më 15.05.2024, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Arkitekturë, BSc 180 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Ivana Milicevic, Philippe Bouillard, dhe Nadia Manzoni është organizuar më 15.05.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 125-të, të mbajtur më datë 03.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet;

- Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë